

VENDIM
Nr. 152, datë 6.3.2025

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2025, MIRATUAR PËR
KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR ORGANIZIMIN E
ZGJEDHJEVE PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikave 1 e 3, të nenit 14, të ligjit nr. 115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2025, zëri “Shpenzime korrente”, në programin buxhetor 01620 “Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale”, i shtohet fondi prej 927 212 000 (nëntëqind e njëzet e shtatë milionë e dyqind e dymbëdhjetë mijë) lekësh, për organizimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 11 maj 2025.

2. Efekti financiar i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për raste të paparashikuara të njërive të qeverisjes së përgjithshme, miratuar për vitin 2025.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku